



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH .nr. 563/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z.Blerim Dina -Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues dhe z. Goran Milenković -Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupei i OE: "International Security Association" Sh.p.k. & "Nazeri 2000" Sh.p.k.- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Rojet e Nderit" Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës", me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal i Prishtinës, me datën: 25.09.2020, mori këtë:

### **URDHRESE**

**I. APPROVOHET** si pjesërisht e bazuar ankesa e grupei të OE: "International Security Association" Sh.p.k. & "Nazeri 2000" Sh.p.k.- Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës", me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal i Prishtinës.

**II. OBLIGOHET**, autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës që të zbatojë vendimet e OSHP-së me numër: Psh. nr. protokollit 332/20 i datës 25 maj 2020 si dhe vendimin 82, 83, 92/20 i datës 03 mars 2020, përkizazi me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës", me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, ndërkëq **URDHËROHET**, autoriteti kontraktues /Komuna e Prishtinës/ që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në, lidhur me zbatimin e vendimeve të OSHP-së.

**III.** Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej pesë ditë kalendarike, do ta detyroj panelin shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK / Komuna e Prishtinës/ sipas nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

**IV.** Me qenë se ankesa e grupit të OE-ve ankues: “International Security Association” Sh.p.k. & “Nazeri 2000” Sh.p.k.- Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

**V.** Obligohet grapi i OE-ve ankues: “International Security Association” Sh.p.k. & “Nazeri 2000” Sh.p.k.- Prishtinë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A R S Y E T I M**

Grupi i operatorëve ekonomik ankues: “International Security Association” Sh.p.k. & “Nazeri 2000” Sh.p.k.- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.08.2020 me nr. 563/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Rojet e Nderit” Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal i Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59 61, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe
- Nenin 3 dhe 4 të Rregullave për tenderët Jo-Normalisht të ulët dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 10.09.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Përgjigje në pretendimi nr.1,** Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 61 dhe 72 të LPP-së si dhe nenin 3 dhe 4 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Eksperti shqyrtues sqaron se marr për bazë që ky aktivitet i prokurimit është përsëritur disa herë, dhe ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar më parë dhe nuk ka të pa thëna në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit pasi që janë përsëritur këto pretendime (janë të njëjta), objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj konsideroj si çështje të gjykuara “res judicata”, sepse AK me rastin e ri-vlerësimit të ofertave nuk i ka zbatuar në tërësi vendimet e OSHP-së. PSH.nr.735,744,757,19 me datë 21.10.2019 dhe PSH.nr. 82,83, 92/20 me datë 11.03.2020 dhe PSH.nr. 332/20 me datë 26.06.2020, sepse AK duhet të merr parasysh qëllimin, mënyrën efikase dhe transparente në pajtim të plotë me Ligjin për Prokurim Publik si dhe kërkesat e parashtuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, andaj pretendimet e OE ankues **nuk janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues.**

Gjithashtu, eksperti Shqyrtues sqaron si në vijim: Është përgjegjësi dhe obligim i Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtojë dhe analizojë çmimin apo të konsiderohet si jo-normalisht i ulët në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkua nga Aneksi I, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura të rregullave ku janë të publikuara në ëeb-faqen e KRPP-së, në formularin B57, Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e “International Security Association” Sh.p.k. & “Nazeri 2000” Sh.p.k.- Prishtinë, të **aprovohet si pjesërisht e bazuar** dhe rekomandon të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës pasi që duke pasur parasysh se shkeljet në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të korrigohen në këtë fazë në mënyrë që Autoriteti Kontraktues me rastin e ri-tenderimit, të hartojë kërkesa dhe kritere të matshme në përputhje me aktivitetin e prokurimit si dhe duke respektuar në tërësi Ligjin dhe Rregullat dytësore për Prokurim Publik.

Autoriteti Kontraktues, me datën 14.09.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 14.09.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli Shqyrtues sqaron se nuk mundet ta anuloj këtë aktivitet te prokurimit për kërkesa qe nuk janë parapare ne dosje, pasi qe, paneli shqyrtues nuk e din cilat janë ato kërkesa apo edhe ndoshta nuk ekzistojnë ato kërkesa, Paneli Shqyrtues e ka kthyer lenden ne rivlerësim qe Autoriteti Kontraktues ti vlerësoj ofertat sipas kërkesave te dosjes se tenderit. Mirëpo gjate rivlerësimit Autoriteti Kontraktues ka shtuar kërkesa te reja qe nuk janë parapare ne dosje ku disa OE i kanë te vendosura çmimet e disa Jo, dhe tani ne ekspertizën e fundit Autoriteti Kontraktues është pajtuar qe ky aktivitet i prokurimit te anulohet, por Anulimin duhet ta beje Autoriteti Kontraktues nëse plotësohen kushtet e nenit 62 te LPP-se, Pasi qe Paneli shqyrtues nuk ka dijeni për qëllimin e inicimit te këtij aktiviteti pra Autoriteti Kontraktues e din qëllimin dhe arsyen e zhvillimit te këtij aktiviteti te prokurimit.

Paneli shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit paneli shqyrtues ka shqyrtuar edhe më parë ankesa të operatorëve ekonomik.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 61 dhe 72 të LPP-së si dhe nenin 3 dhe 4 të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Paneli shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që ky aktivitet i prokurimit është përsëritur disa herë, dhe ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar më parë dhe kemi të bëjmë me pretendime (janë të njëjta), objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, kjo çështje konsiderohet si çështje e gjykuar “res judicata”, sepse AK me rastin e ri-vlerësimit të ofertave nuk i ka zbatuar në tërësi vendimet e

OSHP-së. PSH.nr. 735,744,757,19 me datë 21.10.2019 dhe PSH.nr. 82,83, 92/20 me datë 11.03.2020 dhe PSH.nr. 332/20 me datë 26.06.2020.

Andaj duke u bazuar në faktin që AK nuk ka marrë parasysh vendimet paraprake për këtë aktivitet të prokurimit paneli shqyrtues konsideron se AK gjatë rivlerësimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe se AK duhet të merr parasysh qëllimin, mënyrën efikase dhe transparente në pajtim të plotë me Ligjin për Prokurim Publik si dhe kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues vlerëson se në vendimin 332/20 sa i përket pretendimeve ankimore për eliminim për çmime jo normalisht të ulëta ka konstatuar: “....Paneli shqyrtues sqaron se nëse bazohemi në vlerat e ofertave financiare të operatorëve ekonomik të cilët sipas AK janë të përgjegjshëm administrativisht dhe trajtohen konform nenit 3 dhe 4 të “Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët” konstatojmë se grupi i OE ankues por edhe asnjëri nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të konsiderohen si operator ekonomik që përbajnjë ofertë financiare Jo-normalisht të ulët”.

Paneli shqyrtues sqaron se AK respektivisht e komisionit të vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, duhet të trajtojë dhe analizojë çmimin në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të këruara nga Aneksi I, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura të rregullave ku janë të publikuara në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57, Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që ta zbatoj në tërsi vendimin PSh. 332/20 i datës 25 maj 2020 si dhe vendimin 82, 83, 92/20 i datës 03 mars 2020, dhe po ashtu të respektohet nen 56 dhe 59 i LPP-së. Paneli Shqyrtues njofton Autoritetin Kontraktues që të ndërmerr masa përzbatimin e vendimit të sapo përmendur brenda pesë (5) ditëve, në të kundërtën Paneli Shqyrtues detyrohet që të shqiptoj masa kundër Autoritetit Kontraktues në kuptim të nenit 105 dhe 131 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në

konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal i Prishtinës

1x1 OE- "International Security Association" Sh.p.k. & "Nazeri 2000" Sh.p.k.- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.